



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 107 dt.18.02.1994

PER
BASHKIMIN E NDERMARRJES SE PERPUNIMIT TE LEKUREVE DHE
NDERMARRJES SE KONFEKSIONIMIT TE LEKUREVE NE NJE
NDERMARRJE ME EMRIN NDERMARRJA E PERPUNIMIT DHE
KONFEKSIONIMIT TE LEKUREVE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.18.02.1994, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës, për bashkimin e Ndërmarrjes së Përpunimit të Lëkurëve me Ndërmarrjen e Konfeksionimit të Lëkurëve në një Ndërmarrje me emrin Ndërmarrja e Përpunim dhe Konfeksionimit të Lëkurëve, në bazë të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.9 dhe 10, dhe të Ligjit “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.2,

VENDOSI

1. Bashkimin e Ndërmarrjes së Përpunimit të Lëkurëve me Ndërmarrjen e Konfeksionimit të Lëkurëve në një Ndërmarrje me emrin “Ndërmarrja e Përpunimit dhe Konfeksionimit të Lëkurëve”.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Prognozës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA